



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I INFERMIERIT TË SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR

VENDIM

NR 226, DATË 08 .11.2023

“PËR CAKTIMIN E DATEVE PËR ZHVILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR PËR
ORGANET E URDHRI TË INFERMIERIT TË SHQIPËRISË”

Në bazë të Ligjit Nr. 9718 datë 19.04.2007 “Për Urdhrin e Infermierit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe në bazë të neneve 52; 53, dhe 54 të Statutit të Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë Këshilli Kombëtar:

VENDOSI

1. Procesi zgjedhor për organet e UISH-së fillon më datë 10 Nëntor 2023 dhe përfundon më 22 Dhjetor 2023.
2. Zgjedhjet do të zhvillohen në tre fazat si më poshtë:
 - I. Faza e parë 10 – 24 Nëntor 2023, Zgjedhjet për anëtarë të Asambleve Rajonale;
 - II. Faza e dytë 25 Nëntor – 10 Dhjetor 2023, Zgjedhja e organeve rajonale;
 - III. Faza e tretë 11 – 22 Dhjetor 2023, zgjedhja e organeve qendrore të UISH-së.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Presidenti i UISH-së dhe Këshillat Rajonal.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I INFERMIERIT TË SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR

VENDIM

NR 227-DATË 08.11.2023

“ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE DHE SHPËRNDARJEN E MANDATEVE SIPAS
STATUTIT PËR KËSHILLAT RAJONALË”

Në bazë të Ligjit Nr. 9718 datë 19.04.2007 “Për Urdhrin e Infermierit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe në bazë të nenit 52 të Statutit të Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë, Këshilli Kombëtar i UISH-së:

VENDOSI

1. Këshillat Rajonal do të organizojnë dhe do të drejtojnë zgjedhjet në nivel Qarku duke ngritur Komisionet Zgjedhore (KZ) në nivel Bashkie dhe do të caktojnë kalendarin e zgjedhjeve për çdo bashki.
2. Shpërndarja e mandateve për anëtarë asambleje në nivel qarku është në raportin 1/25 anëtarë sipas përcaktimeve Statuore. Lidhja nr. 1 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Procesi zgjedhor do të monitorohet nga përfaqësuesit e UISH-së dhe komisionet zgjedhore sipas institucioneve që do të ndjekin procedurën dhe të mbikqyrin zgjedhjet duke mbajtur proces-verbalet përkatëse.
4. Në rast mosrealizimi të zgjedhjeve në datën e caktuar në kalendar, caktohet një ditë tjetër jo më vonë se 2 ditë. Votimi në këtë rast kryhet me përfaqësuesit e pranishëm në takim. Komisionet Zgjedhore kujdesen për mbajtjen e proces-verbaleve përkatëse.
5. Mbas përfundimit të zgjedhjeve dhe mbylljes së votimeve KZ dërgojnë për verifikim listën e fituesve në Komisionin e Mandateve në qark, për verifikim të plotësimit të kushteve për anëtarë të Asamblesë Rajonale.
6. Lista e verifikuar e pikës 5 dhe lista e Kandidatëve për organet rajonale të UISH-së dërgohen në Këshillin Kombëtar për përgatitjen e Mandateve dhe Fletëve të Votimit.
7. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Presidenti, Këshillat Rajonal, Komisionet Zgjedhore dhe Komisioni i Mandateve.
8. Të gjithë anëtarët që kandidojnë për organet e UISH-së, duhet të dorëzojnë dokumentacionin përkatës pranë zyrave të UISH-së në qarqe (Kërkesë, CV dhe vërtetim vjetërsie në punë).
9. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Presidentët dhe Këshillat Rajonal të UISH-së.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI UISH

BLERINA BEKTA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I INFERMIERIT TË SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR

VENDIM

NR 228, DATË 08 .11.2023

“PËR CAKTIMIN E DATAVE PËR ZHVILLIMIN E ASAMBLEVE RAJONALE DHE ZGJEDHJET E ORGANEVE RAJONALE NË NIVEL QARKU”

Në bazë të Ligjit Nr. 9718 datë 19.04.2007 “Për Urdhrin e Infermierit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe në bazë të nenit 54 të Statutit të Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë, Këshilli Kombëtar i UISH-së,

VENDOSI

1. Caktimin e datave për zhvillimin e Asambleve Rajonale dhe zgjedhjen e Këshillit Rajonal, i cili zgjedh Presidentin, Zv. Presidentin dhe Sekretarin si më poshtë:

a)	25.11.2023	Qarku Dibër	Ora 10 ⁰⁰
b)	01.12.2023	Qarku Korçë	Ora 09 ⁰⁰
c)	01.12.2023	Qarku Elbasan	Ora 15 ⁰⁰
d)	02.12.2023	Qarku Kukës	Ora 09 ⁰⁰
e)	02.12.2023	Qarku Durrës	Ora 15 ⁰⁰
f)	04.12.2023	Qarku Tiranë	Ora 09 ⁰⁰
g)	05.12.2023	Qarku Shkodër	Ora 09 ⁰⁰
h)	05.12.2023	Qarku Lezhë	Ora 15 ⁰⁰
i)	06.12.2023	Qarku Fier	Ora 09 ⁰⁰
j)	06.12.2023	Qarku Gjirokastrë	Ora 15 ⁰⁰
k)	07.12.2023	Qarku Vlorë	Ora 09 ⁰⁰
l)	07.12.2023	Qarku Berat	Ora 15 ⁰⁰
2. Kandidatët për Këshillin Rajonal, për President, për zv/President dhe Sekretar Rajonal, duhet të depozitojnë kërkesën dhe CV-në pranë Këshillit Rajonal; Komisionit të Pranimit të Kandidaturave jo me vonë se 10 ditë përpara zhvillimit të Asamblesë Rajonale.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Këshilli Rajonal, Presidentët Rajonal dhe Komisioni i Pranimit të Kandidaturave.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I INFERMIERIT TË SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR

VENDIM

NR 229 DATË 08.11.2023

“PËR SHPËRNDARJEN E MANDATEVE SIPAS QARQEVE PËR ZGJEDHJENE E ANËTAREVË TË KËSHILLIT NGA ASAMBLEJA KOMBËTARE”

Në bazë të Ligjit Nr. 9718 datë 19.04.2007 “Për Urdhrin e Infermierit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe në bazë të nenit 11 të Statutit të Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë, Këshilli Kombëtar i UISH-së,

VENDOSI

1. Mandatet për Këshillin Kombëtar, që do të zgjedhe Asambleja Kombëtare do të jenë nga qarqet me numrin më të madh të antërsisë, si më poshtë:
 - Dy anëtarë nga Qarku Tiranë;
 - Një anëtarë nga Qarku Fier;
 - Një anëtarë nga Qarku Elbasan;
 - Një anëtarë nga Qarku Korçë.
2. Kërkesat e kandidatëve për anëtarë të Këshillit do të dorëzohen brenda datës 11 Dhjetor 2023 pranë Komisionit të Mandateve, të Statutit dhe Pranimit të Kandidaturave pranë Këshillit Kombëtarë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I UISH
BLERINA DUKA